

VENDIM
Nr.20, datë 23.6.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Hi1mi Dak1i, Anëtar i ""

Mano1 Konomi, Anëtar i ""

Zija Vuci, Anëtar i ""

Franc Jakova, Anëtar i ""

Ha1i1 Kopani, Anëtar i ""

Alfred Karamuço, Anëtar i ""

Ve1i Budo, Anëtar i ""

me sekretare Drita Fi1to. më datë 21.6.1997 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr .24 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: FRROK CUPI, i përfaqësuar nga avokat Mark Pëllumbi.

SUBJEKT I INTERESUAR: KOMISIONI SHTETËROR PËR KONTROLLIN E FIGURËS SË ZYRTARËVE DHE PERSONAVE TË TJERË në mungesë.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.18, datë 24. 4.1996 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi kërkuesin, përfqësuesin e tij dhe shqyrtoi çështjen në tërësi.

VËREN:

Komisioni Shtetëror për Verifikimin e Figurës së Zyrtarëve dhe Personave të tjerë, me vendimin nr.2, datë 11.4.1996 ka vendosur se kërkuesi Frrok Çupi nuk mund të kandidohet për deputet në zgjedhjet e vitit 1996, për shkak se figuron i regjistruar në regjistrin model 1/1 me numër rendor 38.

Mbi ankimin e tij Gjykata e Kasacionit e ka administruar regjistrin e sipërpërmendur, duke fiksuar nga shënimet e regjistrit në procesverbalin gjyqësor identitetin e kërkuesit dhe fjalët: "me cilësinë regjistër i fashikujve të verifikimit". Më tej në procesverbal është pasqyruar thënia e ekspertit se regjistri në fjalë është "regjistër agjenturor".

Mbi këtë bazë kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, me vendimin nr.18, datë 26.4.1996 ka vendosur refuzimin e kërkesës së kërkuesit, me arsyetimin e vetëm se: "ka bërë pjesë në funksionet e përfshira në nenin 2 të ligjit", duke e quajtur vendimin e komisionit të drejtë.

Në këto kushte, si Komisioni Administrativ për Verifikimin e Figurës së Personave ashtu edhe kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, kanë marrë vendimet përkatëse, pa respektuar parimin kushtetues për një proces të rregullt ligjor, sanksionuar me nenin 38 të Ligjit Kushtetues për "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut".

Parregullsia e vendimit të Komisionit të Verifikimit qëndron në faktin se, në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr.8043, datë 30.11.1995 "Për Kontrollin e Figurës së Zyrtarëve dhe Personave të tjerë", është kufizuar në citimin e nenit 2 të këtij ligji, pa përcaktuar asnjë nga shkaqet e renditura në shkronjat e kësaj dispozite.

Kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit duhej që në fillim të kërkonte saktësimin e plotësimin e këtij vendimi sipas kërkesave të ligjit.

Përpjekjet e kolegjit civil për të ndriçuar disa rrethana, siç del nga procesverbali gjyqësor, nuk kanë sjellë ndonjë fakt konkret. Përkundrazi, në atë procesverbal (faqe 5), është fiksuar se : "Komisioni i Verifikimit të Figurave e ka preçizuar në gërmën "ç" të ligjit".

Ky pasqyrim i procesverbalit e bën edhe më të paqartë vendimin e Gjykatës.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimi i kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit, duhet të shfuqizohet si antikushtetues për shkak të mungesës së motivimit dhe

për shkak të procesit jo të rregullt ligjor, parime këto të sanksionuara nga neni 9 i Ligjit Kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 dhe neni 38 të Ligjit Kushtetues për "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut".

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24 pika 3 dhe 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", njëzëri,

V E N D O S I:

Shfuqizimin e vendimit nr.18, datë 26. 4.1996 të kolegjit civil të Gjykatës së Kasacionit.

Urdhërohet rishqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Kasacionit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më datë 23. 6.1997

Nr. 24 i regjistrit themeltar .

Nr. 20 i vendimit.